

VENDIM
Nr. 111, datë 27.7.2017

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RTS SHPK
NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 7 dhe 10, pika 2 dhe 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2017; VKM-në nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë RTS sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria RTS sh.p.k., në bazë të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, rezultoi:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- germa “a” (të dhënat për aplikim), germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) germa “c” (të dhëna për aplikuesin) plotësuar.

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 2:

- germa “a”/“b” (akti i themelimit/statuti) plotësuar;
- germa “c” (vërtetimi i regjistrimit nga QKB) plotësuar;
- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë) pa plotësuar;
- germa “f”, subjekti nuk ka paraqitur autorizim të lëshuar nga MEI në lidhje me ushtrimin e këtij aktiviteti;

- germa “g”, subjekti ka paraqitur marrëveshje me bashkinë Devoll (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtimi), për zonën ku do të shtrihet projekti i ndërtimit.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave), subjekti nuk ushtron aktivitet tregtar, për rrjedhojë nuk ka detyrime ndaj tatim-taksave;

- germa “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit), subjekti është themeluar më datë 5.6.2017, për rrjedhojë nuk mund të disponojë bilanc financiar;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) pa plotësuar;

- germa “d” (vërtetimin e pagesës së regjistrimit për aplikim në llogari të ERE-s) pa plotësuar.

Dokumentacioni teknik për centralet SOLARE

Neni 9, pika 4.1 - Të dhënat teknike për centralet SOLARE, plotësuar.

Neni 9, pika 4.2 - Të dhënat teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, plotësuar.

Neni 9, pika 4.3 - Dokumentacioni teknik dhe grafik, plotësuar.

Neni 9, pika 4.4 - Dokumentacioni tekniko - ekonomik, pa plotësuar.

Neni 9, pika 4.5 - Leje nga institucione të tjera, pa plotësuar.

Kërkesa e paraqitur nuk plotëson kushtet e një aplikimi, në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë RTS sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me fuqi të instaluar 2 MW.

2. Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” brenda 1 muaji nga marrja e këtij vendimi, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE-S

Adriatik Bego